VENDIM
Nr.40, datë 26.10.2005

MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE "DUKAGJINI AL" SHA PËR 6- MUJORIN E PARË TË VITIT 2005

Në mbështetje të shkronjave "d" dhe" k" të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve", nenit 107 dhe 175, pika 2 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", pasi shqyrtoi materialet e përgatitura nga organi ekzekutiv, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Ti kërkojë shoqërisë së sigurimit "DUKAGJINI AL" sh.a. të autorizuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve për ushtrim aktiviteti në sigurime me nr.7, datë 8.7.2004 dhe me leje të ushtrimit të aktivitetit në sigurime nr 7/1, datë 10.9.2004, që brenda një periudhe jo më shumë se dy muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi për mbulimin e përgjegjësive që rezultojnë mbi mundësitë e saj siç parashikohen nga neni 107 i ligjit të sipërpërmendur:

a) Të marrë masa për risigurimin, rritjen e kapitalit themeltar në nivelin e kërkuar dhe të depozitojë në llogarinë qëllimore fondin e kërkuar të garancisë.

b) Në rast të mospërmbushjes të kërkesave të pikës 1/a, shoqëria të zgjidhë kontratat e përgjegjësive të marra, që janë në tejkalim të kërkesave të dekretit nr.107 të ligjit të sipërpërmendur.

2. Deri në momentin e ngurtësimit të fondit të garancisë sipas kërkesave të pikës 2/a të nenit 98 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, shoqëria ndalohet të lidhë kontrata të reja sigurimi që i përkasin klasave 10, 11, 12, 13, 15, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

3. Deri në momentin e ngurtësimit të fondit të garancisë sipas kërkesave të pikës 2/b të nenit nr.98 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, shoqëria ndalohet të lidhë kontrata të reja sigurimi që i përkasin klasave 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, sipas klasifikimit të parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

4. Brenda 10 ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të emërohet Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë.

5. Ngarkohet shoqëria "DUKAGJINI AL" sh.a. dhe Ekzekutivi i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.10.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba